



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU - BASIC COURT OF PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.5/24

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Kryetarja e gjykatës Shpresa Emra, duke vepruar sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të parashtruar nga ana e ankuesit K..com-B..... Kosova, ndaj gjyqtares N. B., gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtares sipas lëndës civile C.nr.553/22, në bazë të së cilës është bërë inicimi i procedurës disiplinore, me dt.17.07.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e ankuesit K..com-B..... Kosova ndaj gjyqtares N. B., gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtares sipas lëndës civile C.nr.553/22.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës K..com-B..... Kosova ka parashtruar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares N. B., gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Civil, lidhur me neglizhencën sipas procedurës civile C.nr.553/22. Nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës ankesa është përcjellë në Gjykatën Themelore në Prizren si Autoritet Kompetent në këtë çështje.

Ankuesi K..com-B..... Kosova në shkresën e emëruar "Informata lidhur me mos reagimin adekuat të gjyqtares N. B., në rastin C.nr.553/22"ka kërkuar që të iniciohet procedura disiplinore ndaj gjyqtares për shkak të shkeljes disiplinore të parapara nga neni 5 par.2.15 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Kërkesa për inicim të procedurës disiplinore është bazuar në gjetjet e emisionit K.P.të transmetuar me dt.05.05.2024 me titull "Dosja e Plagosjes". Sipas të gjeturave në këtë emision ka pasur shkelje serioze nga ana e stafit të Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Dragash gjatë trajtimit të ç[shtjes gjyqësore të palëst ë dhënave këtë emision pala O.M., ka hyrë në gjykatë, në sallë të gjykimit me armë zjarri, pa u kontrolluar nga sigurimi i Gjykatës, gjyqtarja N. B., nuk ka

ndërmarr masa për të siguruar qetësi dhe rend giatë gjykimit në çështjen e viktimës H.Q., përkundër se ka qenë në dijëni se viktima është kërcënuar brenda gjykatës, nuk ka siguruar prezencën e policisë dhe sigurimit të gjykatës edhe pse paraprakisht ishte njoftuar se mund të kishte probleme për shkak të kërcënimeve në korridor të gjykatës. Për të gjitha këto si provë konsiderohet dëshmia e viktimës dhe deklaratimet e saja në emision si dhe incizimet të cilat i ka regjistruar në telefonin e saj privat dhe të cilat janë publikuar në emision. Në këto incizime të cilat janë realizuar në korridor të Gjykatës Themelore në Dragash shihen veprimet dhe fjalët kanosëse të cilat i ka përdorur O.M.,. Më pas kur palët kanë hyrë në sallën e gjykimit kërcënimet kanë vazhduar dhe sipas dëshmitares gjyqtarja ka tërhequr vërejtjen në dy tri raste dhe të njëjtat i ka shënuar në procesverbal, por nuk ka ndërmarr masa tjera për parandalim dhe për siguri të viktimës dhe i dyshuari është larguar nga salla e gjykatës pa ndalesë. Viktima është larguar nga gjykata pas të dyshuarit dhe më pas jashtë gjykatës edhe ka ndodhur rasti i plagosjes së babait të viktimës. Sipas deklaratës së viktimës lidhur me posedimin e armës nga ana e të dyshuarit O.M., e njëjta nuk ka pasur dijëni nëse ai e ka pasur ose jo armën me vehte në gjykatë.

Sipas ankuesit dhe të dhënave të cilat i ka siguruar për të kaluarën kriminale të O.M., i njëjti ka pasur disa raste në gjykatë duke filluar nga Viti 2009 gjer më vitin 2021 ku është dënuar për vepra penale si i mitur dhe si madhor (lëndim i lehtë trupor, dhuna në familje, mospërfillja e vendimit të gjykatës).

Në bazë të gjetjeve të lartcekurave ankuesit pretendojnë se gjyqtarja N. B., me veprimet e saja ka rënë ndesh me nenin 5 paragrafin 2.15 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve i cili përcakton shkelje e detyrave të punës së gjyqtarit ku gjyqtari përfshihet me sjellje në detyrë ose privatisht të cilat sjellje dëmtojnë reputacionin e gjykatës ose mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e gjyqësorit dhe për këtë kanë parashtruar kërkesë për inicim të procedurës disiplinore.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar ankesë ndaj gjyqtarës N. B., gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm Divizioni Civil, lidhur me lëndën C.nr.553/22 ka iniciuar hetimet preliminare për procedurë disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shikimin në ankesën e parashtruar dhe ka kërkuar deklaratë nga gjyqtarja e çështjes.

Gjyqtarja në deklaratën e saj lidhur e pretendimet e ankuesit ka cekur se nuk qëndrojnë pretendimet e paraqitura në kërkesën e parashtruar në lidhje me veprimet ose mosveprimet e saja në rastin konkret. Sipas gjyqtarës me &.26.04.2024 ka pasur dy seanca gjyqësore në Gjykatën Themelore në Dragash si gjyqtare e deleguar për shkak të përjashtimit të gjyqtarës së angazhuar në Dragash. Seanca e parë ka qenë e caktuar në orën 9.30min dhe seanca e dytë që ka të bëjë me rastin konkret C.nr.553/22 ka qenë e caktuar në ora 10.30min. E gjithë ngjarja e cila është transmetuar në emision ka ndodhur në korridor të gjykatës gjatë kohës kur është mbajtur seanca e parë në sallën e gjykimit. Gjyqtarja nuk ka pasur mundësi të shih dhe të dëgjon se çka po ndodh jashtë sallës së gjykimit. Vetëm kur ka përfunduar seanca e parë dhe kur janë larguar palët ka kuptuar se palët që kanë të caktuar seancën e dytë janë jashtë dhe po dëgjohe zërat e tyre, ka kërkuar prej zyrtarës që ti fton në sallën e gjykimit dhe të fillojë seancën. Pasi kanë hyrë në sallën e gjykimit ka tentuar që ti qetësojë situatën dhe të bisedon me palët duke i rikujtuar se ata kanë një fëmijë të përbashkët dhe duhet të veprojnë në interes më të mirë për fëmijën. Përkundër tentimeve për të qetësuar situatën pala O.M., nuk e ka respektuar rendin dhe qetësinë për çka i ka shqiptuar vërejtje gjyqësore në kuptim të nenit 288 dhe 289 të LPK-së dhe ka urdhëruar që të largohet nga seanca. I njëjti nuk ka rezistuar dhe është bindur urdhrin të gjykatës për tu larguar nga salla e gjykimit. Duke u larguar ka kërcënuar gjyqtarën e çështjes me fjalë "me ty do të merrem privatisht", por është larguar pa asnjë problem dhe nuk ka pasur

arsye të sigurohet asistenca e sigurimit të gjykatës. Pasi që ai është larguar pala e paditur H.Q., dhe avokati i saj N.K., kanë qëndruar për një kohë prej 15 min në sallën e gjykimit me qëllim të mos ketë kontakt me palën paditëse për shkak të situatës së tensionuar. E gjithë kjo është shënuar në procesverbal nga ana e gjyqtarës. Gjyqtarja ka cekur se nuk qëndron fakti se pala e paditur ka kërkuar që ajo të thërras policinë ashtu siç ceket në emision, kjo mund të vërtetohet edhe nga ana e dëshmitarëve, gjyqtarëve porotë dhe vet avokati i palës. Gjithashtu, ka cekur se pas përfundimit të seancës për veprimet e palëve dhe kanosjes ka paraqitur rastin në Prokurorinë Themelore në Prizren, ka njoftuar Kryetaren e Gjykatës dhe Mbikëqyrësin e Gjykatës Themelore në Dragash i cili gjithashtu ka qenë prezent në gjykatë atë ditë. Më pas është kthyer në Gjykatën Themelore në Prizren ku edhe e ka zyrën dhe punon. Pas kësaj ka kuptuar për rastin që ka ndodhur jashtë gjykatës ku është plagosur babai i të dëmtuarës i cili nuk ka qenë palë në procedurë dhe nuk ka marrë pjesë në seancë. Sa i përket faktit se çka ka ndodhur në korridorin e gjykatës derisa ajo ka qenë në gjykim ajo ka informuar personat kompetent për këtë situatë dhe konsideron se rendi dhe qetësia në korridor të gjykatës nuk është përgjegjësi e saj por e personave të sigurimit. Në lidhje me pretendimet se si provë për të gjithë ngjarjen duhet të merret emisioni i lartcekur, kjo nuk mund të konsiderohet si provë për rrjedhën e seancës të cilën ajo e ka udhëhequr dhe ka gjykuar. Provë është vet procesverbali i kësaj seance. Gjithashtu, fakti se O.M., ka hyrë me armë në gjykatë nuk është kompetencë e gjyqtarës të kontrolloj ose të verifikoj palët të cilët hyjnë në gjykatë, kjo është kompetencë e organeve të sigurimit. Sipas LPK-së mbajtja e rendit dhe qetësisë në gjykim është detyrë e gjyqtarit dhe nuk nënkupton praninë e policisë. Andaj, nga të gjitha të lartë theksuara gjyqtarja konsideron se nuk qëndrojnë të paraqiturat në kërkesë dhe se kjo ka ardhur si pasojë e keqinformimit të paraqitësit të ankesës nga ana e palëve.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar deklaratën nga gjyqtarja e çështjes, ka bërë verifikimin e shkresave të lëndës C.nr.553/22, ka bërë shikimin në emisionin e cekur në Kërkesë, ka bërë shikimin në incizimet e kamerave të sigurisë të Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Dragash me d.l. 26.04.2024. Gjithashtu, është bërë shikimi në Shënimin zyrtar nga ana e gjyqtarës N. B., drejtuar Kryetares së Gjykatës me d.l. 26.04.2024, deklaratës së mbikëqyrësit të Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Dragash me d.l. 30.04.2024 dhe Shënimin zyrtar të Kryetares së Gjykatës në Prizren me d.l. 02.05.2024 drejtuar Ndhmës administratorit të Gjykatës në Dragash, ka bërë shikimin në deklaratën e ndihmës administratorit të Gjykatës Themelore në Prizren — Dega në Dragash GJA.nr.27/24 me d.l. 03.05.2024, në deklarimin e dhënë nga punëtori i sigurimit SH.M. me d.l. 03.05.2024, në kërkesën për inicim të procedurës disiplinore SH.M - për punëtorin e sigurimit në Gjykatën Themelore në Prizren - dega në Dragash e evidentuar me numër I/AGJ.nr. 1/2024-28 me d.l. 10.05.2024.

Pas vlerësimit dhe analizës së tërësishme të provave të mbledhura Autoriteti Kompetent konsideron se:

Ankesa është e pabazuar.

Autoriteti kompetent - Kryetarja pas verifikimit të gjithë dokumentacionit ka vërtetuar gjendjen faktike si vijon:

Në Gjykatën Themelore në Prizren - Dega në Dragash në rrjedhë e sipër është procedura kontestimore sipas padisë së paditësit O.M., nga fshati Bresanë, Komuna e Dragashit, të cilin me autorizim e përfaqëson av. B.Sh., nga Fushë Kosova dhe av. K.M., nga Prizreni, kundër të paditurës H.Q., nga Dragashi të cilën me autorizim e përfaqëson av. N.K., nga Dragashi, për shkak të ndryshimit të aktgjykimit të besimit të fëmiut. Lënda është evidentuar me shenjë

C.nr.553/22 dhe me të njëjtën është ngarkuar gjyqtarja N. B., gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prizren, pas përjashtimit të Gjyqtares Sabaheta Kurteshi nga Gjykata Themelore në Prizren - Dega në Dragash.

Gjyqtarja N. B., pas pranimit të lëndës në afatin ligjor ka caktuar 4 seanca dhe i ka mbajtur në Gjykatën Themelore në Prizren-Dega në Dragash, si gjyqtare e deleguar nga Gjykata Themelore në Prizren. Tre seancat e para i ka mbajtur pa kurrfarë problemi dhe në seancën e datës 26.04.2024 pas përfundimit të seancës, jashtë objektit të gjykatës paditësi O.M., ka plagosur me armë zjarri babain e të paditurës H.Q.,.

Gjyqtarja me këtë datë.26.04.2024 ka pasur të caktuara dy seanca si gjyqtare e deleguar në Dragash, një në ora 9.30min dhe një në ora 10.30min (lënda kontestuese C.nr.553/22). Derisa ka qenë duke mbajtur seancën në ora 9.30min në korridorin e gjykatës kanë qëndruar palët të cilët kanë pasur seancën në ora 10.30min. Me këtë rast paditësi O.M., ka prishur rendin dhe qetësinë duke e kanosur të paditurën H.Q., në prezencë të babait të saj dhe avokatit N.K.,. Këtë situatë e ka incizuar me telefon privat e paditura H.Q.,. Kjo është vërtetuar edhe me shikimin në kamerat e sigurimit të gjykatës ku ka Video incizim, por jo edhe audioincizim, nuk ka zërim. Më pas palët kanë hyrë në sallën e gjykimit nr. I ku nuk ka më pamje audio, Por se nga procesverbali i përpiluar nga ana e gjyqtares është vërtetuar se paditësi edhe në sallën e Rj ykimit nuk ka respektuar rendin dhe qetësinë dhe gjyqtarja pas dy vërejtjeve e ka përjashtuar nga Salla e gjykimit. Ai është larguar pa kundërshtuar, por paraprakisht e ka kanosur gjyqtaren.

Nga procesverbali i përpiluar nga ana e gjyqtares është vërtetuar se shqyrtimi kryesor është mbajtur me dt.26.04.2024 në prezencë të palëve paditësit O.M., personalisht, të Paditurës H.Q., personalisht dhe avokatit të saj N.K.,, si dhe në prezencë të dy anëtarëve të trupit gjykues, gjyqtarë porotë. Që në fillim të seancës O.M., fillon të fyejë avokatin e palës së paditur dhe nuk e lë gjykatën të vazhdojë me rrjedhën normale të procedurës dhe pas kësaj gjyqtarja merr aktvendim me të cilin i tërheq vërejtjen të paditurit O.M., , pas shqiptimit të vërejtjes i padituri vazhdon me ofendime ndaj gjykatës dhe të paditurës dhe gjyqtarja merr aktvendim me të cilën e largon paditësin nga salla e gjykimit. Paditësi duke u larguar nga salla e gjykimit i drejtohet gjyqtares me fjalë "me ty kemi mu marr privatisht". Pas kësaj gjyqtarja merr vendim që seanca nuk do të mbahet dhe caktohet seanca e radhës.

Nga incizimet e kamerave të sigurisë shihet se fillimisht nga salla e gjykimit është larguar paditësi O.M., dhe pas një kohe të caktuar largohen edhe pala e paditur H.Q., dhe avokati N.K.,. Nga e gjithë kjo situatë e përshkruar dhe duke krahasuar rrjedhën kronologjike të ngjarjes shihet se gjyqtarja ka ndërmarrë masa të cilat i parasheh Ligji Procedurës Kontestimore në rastin konkret dhe i ka zbatuar autorizimet të cilat i takojnë si gjyqtare e çështjes. Gjithashtu, gjyqtarja po atë ditë fillimisht me telefon dhe më pas me shkrim më ka informuar si Kryetare për rrjedhën e ngjarjes, ka informuar mbikëqyrësin e Gjykatës Themelore Dega në Dragash si dhe ka parashtruar kallëzim penal në Prokurorinë Themelore në Prizren në lidhje me kanosjen e bërë nga ana e O.M.,. Të gjitha këto janë vërtetuar në bazë të deklaratave të dorëzuara nga ana e gjyqtares.

Sipas detyrës zyrtare pasi që kam pranuar shënimin zyrtar të gjyqtares dhe Mbikëqyrësit të Degës në Dragash kam kërkuar që të sigurohen incizimet nga kamerat e sigurisë dhe pas shikimit të të njëjtëve kam konstatuar se e gjithë ngjarja ka ndodhur në korridorin e gjykatës, paditësi nuk është kontrolluar nga ana e sigurimit të gjykatës dhe për këtë kam kërkuar informatë nga ana e Ndhmës administratorit të Degës në Dragash për sqarim rreth çështjes së punës së punëtorit të sigurimit i cili ka qenë në detyrë në atë kohë dhe pas pranimit të informatës përmes administratores kam parashtruar kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj

punëtorit të sigurimit SH.M. të evidentuar si I/AGJ.nr.I/2024-28 me cit. 10.05.2024. Procedura vazhdon nga ana e Komisionit disiplinor në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Nga të lartcekurat si Autoritet Kompetent konsideroj se në rastin konkret është e vërtetë që ka ndodhur një rast i plagosjes por kjo ka ndodhur jashtë objektit të gjykatës dhe ndaj një personi të tretë i cili nuk ka qenë palë në gjykatë, por i cili rast motivin dhe zanafillën e ka pasur në konfliktin të cilin e kanë pasur palët në procedurë kontestimore e Cila procedurë ka të bëjë me një çështje shumë të ndjeshme të besimit të fëmijës dhe se kjo ngjarje bartë pjesërisht përgjegjësinë edhe në gjykatë, respektivisht në personat e autorizuar dhe të cilat e kanë për detyrë që të kujdesen që secila palë të ketë siguri në gjykatë, të ketë rend dhe qetësi para, pas dhe gjatë gjykimit. Kjo detyrë i takon sigurimit të gjykatës dhe për këtë arsye kam inicuar procedurë disiplinore për shkak të mosrespektimit të detyrave të punës ndaj punëtorit të sigurimit në kohën kur ka ndodhur ngjarja.

Gjyqtarja i ka ndërmarrë të gjitha veprimet të cilat i ka pasur në dispozicion si gjyqtare e rastit dhe sjellja e saj nuk paraqet sjellje të pahijshme ashtu si pretendohet nga ana e ankuesit.

Andaj, si Autoritet Kompetent bazuar në të lartcekura konsideron se gjyqtarja N. B., në veprimet e saja nuk ka pasur shkelje të cilat konsistojnë me shkeljet disiplinore të parapara me nenin 5 par.2.1 5 të Ligjit për Përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ku është paraparë shkelje sa i përket sjelljes, qoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e Gjykatës ose mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e gjyqësorit.

Për arsyet e cekura më lartë, Autoriteti Kompetent — Kryetarja e Gjykatës ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-U57 për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.5/2024, me dt.17.07.2024



T

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e paraparë e drejta e ankesës.